



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА KËSHILLI GJYQËSOR | REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenit 41 paragrafi (1) neni 45 dhe neni 46 paragrafi (1) pika (1) të Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë" nr.58/06, 35/08, 1650/10, 83/18, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.96/19) dhe neni 47, neni 49 dhe neni 50 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.102/19), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur me datë 30.04.2025 miratoi:

VENDIM PËR ZGJEDHJEN E GJYQTARIT NË GJYKATËN THEMELORE STRUGË

Për gjyqtar në Gjykatën Themelore Strugë është zgjedhur: Nderim Polisi

Vendimi do të publikohet në web faqen e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pas potëfuqishëmërisë dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

ARSYETIM

Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me vendimin nr.09-611/1 nga 11.03.2025 publikoi shpallje nr.09-611/2 nga 11.03.2025 për zgjedhjen e gjyqtarve në Gjykatën Themelore Berovë, Gjykatën Themelore Veles, Gjykatën Themelore Vinicë, Gjykatën Themelore Civile-Shkup, Gjykatën Themelore Penale-Shkup, Gjykatën Themelore Dellçevë, Gjykatën Themelore Kavadar, Gjykatën Themelore Kërçovë, Gjykatën Themelore Koçani, Gjykatën Themelore Kratovë, Gjykatën Themelore Kriva Pallnakë, Gjykatën Themelore Negotinë, Gjykatën Themelore Radovish, Gjykatën Themelore Strumicë, Gjykatën Themelore Strugë dhe Gjykatën Themelore Shtip ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.55/25 nga 12.03.2025).

Në shpalljen e publikur për në Gjykatën Themelore Strugë është paraqitur 1 (një) kandidatë i cili i ka plotësuar kushtet e paraparë me ligj.

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut formoi Komisionin i cili zhvilloi një intervistë me kandidatin e aplikuar, gjatë së cilës pati mundësinë të vlerësojë aftësitë e kandidatëve për kryerjen e funksionit gjyqësor me përgjegjësi, vlerat e tyre etike dhe morale, qasjen ndaj drejtësisë, motivimin profesional, aftësitë komunikuese, marrëdhëniet profesionale dhe kompetencat sociale, dhe në bazë të pikëve të marra nga intervista me kandidatët, suksesin në Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë dhe vitin në të cilin është kryer trajnimi për secilën pozitë gjyqësore në konkurs, bën renditjen e kandidatëve të intervistuar.

Në seancën e mbajtur më 30.04.2025, secili anëtar i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka shpjeguar mënyrën e votimit dhe kandidati Nderim Polisi ka marrë shumicën e nevojshme të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, me të drejtë vote.

Në bazë të nenit 45 të Ligjit për Gjykatat, kandidati i plotëson kushtet e përgjithshme për zgjedhjen e gjyqtarit.

Kandidati Nderim Polisi ka marrë gjithsej 56.93 pikë, ku 51.76 pikë nga suksesi në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë dhe 5.17 pikë nga Komisioni nga intervista e zhvilluar.

Kandidati Nderim Polisi është kandidat nga gjenerata e VIII-të e kandidatëve të Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, ka diplomuar më 06.05.2005 në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, dhe e ka dhënë provimin e jurisprudence më 05.12.2013, ka gjithsej 16 vjet e 2 muaj e 15 ditë, gjegjësisht 11 vjet e 3 muaj e 12 ditë, pas dhënies së provimit të jurisprudence

Në përputhje me lart përmendur, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e 30.04.2025, solli vendim për zgjedhjen, me të cilin Nderim Polisi është zgjedhur si gjyqtar në Gjykatën Themelore Strugë.

**KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Kryetar

м-р Александар Камбовски



Nr.09-1178/25

08.05.2025

Shkup